



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:051022

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02403845

C.nr.1003/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen juridike të paditësit Sh. Q nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Ilir Shaqiri nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson B. M - Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, gradimit dhe kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e objektit: 4,197.50€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik /për shkak të pandemisë Covid-19/, të mbajtur më datë 12.11.2021, merr këtë;

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditësit Sh. Q nga Gjilani dhe **detyrohet** e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit, t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,328.00€, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për 644 ditë pune, për periudhën kohore 19.04.2017 – 18.06.2021, kurse në emër të licencimit, për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020, shumën prej 2,640.00€, si dhe në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë pune, për 50% të një page bazë, shumën prej 229.50€, gjithsej shumën e përgjithshme prej 4,197.50€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 17.04.2020/*data e ushtrimit të padisë/* e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore, në lartësi prej 280.00€, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Sh.Q nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, av. Ilir Shaqiri nga Gjilani, ka ushtruar padi dhe me parashtrësë, të datës 12.11.2021, ka bërë ndryshimin e padisë ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për 644 ditë pune, në vlerë prej 2 (dy) euro për ditë pune, për periudhën kohore 19.04.2017 – 18.06.2021, t'ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 1,328.00€, në emër të licencimit, për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020, shumën prej 2,640.00€, si dhe në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë pune, për 50% të një page bazë, shumën prej 229.50€, gjithsej shumën e përgjithshme prej 4,197.50€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 17.04.2020/*data e ushtrimit të padisë/* e

deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përbarimit të dhunshëm ligjor.

Përfaqësuesi i paditësit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës, duke i specifikuar ato, edhe atë:

Për përpilimin e padisë - shumë prej 104.00€, për përfaqësim në një seancë gjyqësore - shumë prej 135.00€, si dhe taksën gjyqësore për padi - në shumë prej 41.00€.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjigjen në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, si dhe ndryshimin e padisë në shqyrtim kryesor, si të pabazuar me ligj, duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjilan nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, meqë e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, e po ashtu ka theksuar se Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkrues të Kontratës së lartcekur janë *MASHT-i/Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/* dhe *SBASHK-u/Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës/* dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të paditurën. Përfaqësuesi i të paditurës e ka kundërshtuar edhe ndryshimin e padisë lidhur me kompensimin për kualifikim dhe licencim, pasi, sipas tij, paditësi është duke u paguar konform koeficientit të paraparë me konkurs për pozitën që ka krijuar marrëdhënie pune dhe se në konkurse të publikuara nga Drejtoria Komunale e Arsimit, nuk ceket askund se i punësuar do të paguhet me shtesë mbi pagën bazë sipas kualifikimit, por sipas pagës së përcaktuar me kontratën e punës dhe se licenca e paditësit si mësimdhënës ka skaduar më 11.09.2017. Gjithashtu, i njëjti ka shtuar se kërkesa për kompensim të shpërblimit jubilar është vjetërsuar edhe konform Ligjit të Punës, neni 78 pika 1, pasi paditësi ka 17 vite përvojë pune, që do të thotë se një kërkesë e tillë është bërë pas 7 viteve dhe se nuk i është adresuar asnjë kërkesë punëdhënesit që në procedurë administrative të realizojë këtë të drejtë e që kjo çështje është primare që të zgjidhet paraprakisht para se të dorëzohet padia në gjykatë, duke shtuar se nuk janë shtjerr mjetet juridike sipas procedurës administrative, ku neni 79 parasheh afatin prej 30 ditëve të realizimit të kësaj kërkesë, si dhe nenin 82 i të njëjtit ligj që specifikon inspektoriatin e punës si autoritet zyrtar të zgjidhjes së kërkesave të kësaj natyre, e që këtë padi e bënë jolëndore mbi bazën e deklarimeve të mësipërme. Përveç tjerave, e paditura ka theksuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartcekur, andaj nga këto arsye ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar me ligj, ashtu që gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit, duke e detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit, që paditësit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për 644 ditë pune, në vlerë prej 2 (dy) euro për ditë pune, për periudhën kohore 19.04.2017 – 18.06.2021, t'ia paguajë shumë prej e të hollave në lartësi prej 1,328.00€, në emër të licencimit, për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020, shumë prej 2,640.00€, si dhe në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë pune, për 50% të një page bazë, shumë prej 229.50€, gjithsej shumë e përgjithshme prej 4,197.50€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 17.04.2020 /data e ushtrimit të

padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së kërkespadiës, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /*Kontrata nr.24, e dt.18.04.2017/*, e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, konkretisht nënin 35 par. 5, ngase në nënin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “*Punonjësit arsimor (anëtarë të SBASHK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”, kurse në bazë të nenit 35.parag 7 të Kontratës, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “*të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënien e punës primare në institucionet arsimore*”. Gjykata konstaton se edhe me Kontratën Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, në nënin 35 janë përcaktuar të njëjtat kushte dhe detyrime për të paditurën.

Në fakt, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është mësimdhënës i Gjuhës Angleze te e paditura, ngase një fakt të tillë e konfirmon Kontrata e punës në emër të paditësit, me numër protokoli ..., e datës 01.09.2016, e poashtu nuk është kontestuese as përvoja e punës mbi 10 vite, ngase këtë fakt e konfirmon Vërtetimi mbi përvojën e punës, me numër protokoli ... lëshuar nga ... “...” në Gjilan.

Poashtu, nuk është kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse as lartësia e kërkesave për ushqimin ditor nga 2 (dy) euro në ditë, por kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse janë ditët e pranisë në punë, respektivisht kërkesa në lartësi prej 1,328.00€, për periudhën kohore nga data 19.04.2017 e deri më datë 18.06.2021, por këtë fakt e konfirmon Vërtetimi për ditët e pranisë në punë, me numër protokoli ..., i datës 18.08.2021, i lëshuar nga institucioni arsimor SHML” në Gjilan, respektivisht Vërtetimi i datës 17.08.2021, i lëshuar nga e njëjta shkollë.

Kontestuese mes palëve mbetet fakti nëse e paditura ka për obligim që paditësit t’ia paguajë kompensimin për kualifikim dhe licencim, fakt ky që vërtetohet nga Diploma Universitare, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë, e dt. 25.06.2008, Licenca e Mësimdhënësit, me numër ..., e dt. 11.09.2012, lëshuar nga MASHT-i/*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/* dhe Teknologjisë e Kosovës dhe Aktvendimi mbi licencimin e mësimdhënësit, lëshuar nga MASHT, i dt. 11.09.2012, për çka gjykata konstaton se e paditura qëndron në detyrim ndaj paditësit, mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /*Kontrata nr.24, e dt.18.04.2017/*, neni 7, ku është përcaktuar se “*Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpërblehet nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit*” dhe paragrafi 1.3 i të njëjtit nen, ku shprehimisht thuhet “*Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar i i shpërblehet 27% e pagës bazë*”.

Gjithashtu, kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, pastaj, nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekte juridike për të paditurën meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj dhe nëse kemi parashkrim të kërkesave konform nenit 87 të Ligjit të Punës/*Ligji nr.03/L-212, i datës 01.Nëntor 2010/*.

Lidhur me pretendimet e të paditurës, gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/*Ligji nr. 06/L – 054/*, në nënin 12.1, decidivisht është përcaktuar se “*Gjykatat Themelore janë kompetente për*

të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe". Kurse, Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat, gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorëve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/Ligji Nr. 03/L-149/, marrëdhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit, ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre, së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e mëpastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata konsideron se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, ka hyrë në fuqi më datë 18.04.2017, kurse paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur më datë 17.04.2020, fakt ky që konfirmohet nga padia e dorëzuar e cila gjendet në shkresat e lëndës, çka do të thotë se të drejtën e tij e ka ushtruar brenda afatit prej 3 vitesh, edhe pse neni 87 i Ligjit të Punës është i paqartë, kur, citoj "*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*", që do të thotë parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e ushtrimit të kërkesës e jo siç duhet të ishte nga dita e ardhjes për pagesë/maturimi i kërkesës/ të çdo kërkesë.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrim ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për institucionet komunale apo DKA-të.

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga gjykata konform nenit 382 të LMD-së/Ligji nr. 04/L-077, i datës 10 maj 2012/, në të cilën dispozitë është përcaktuar se "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*".

Ndërsa, vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e paditësit në kontest, ashtu që e detyroi të paditurën që t'ia kompensojë paditësit shpenzimet, në lartësi prej 280.00€, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, edhe atë për përpilimin e padisë - shumën prej 104.00€, për përfaqësim në një seancë gjyqësore - shumën prej 135.00€, si dhe taksën gjyqësore për padi - në shumë prej 41.00€.

Nga të cekurat më lart, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:051022, 12.11.2021

Numri i lëndës: 2020:051022
Datë: 16.11.2021
Numri i dokumentit: 02403845

G j y q t a r i,
Berat Spahiu

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:051022
Datë: 16.11.2021
Numri i dokumentit: 02403845